



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË

KOMUNA E ISTOGUT-Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson menaxherja, Zizë Bujupaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëërën anë;

dhe

NTSH "Seykos" Shpk - nga Suhareka, të cilën e përfaqëson z. Shpejtim Kuçi ne cilësinë e drejtorit të ndërmarrjes me nr. te Rexh. Biznesit 70429369 (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

"FURNIZIMI ME KONTENJER PËR MBETURINA NE TERITORIN E KOMUNËS SË ISTOGUT

Nr. I prokurimit	633-18-820-1-2-1/B08
Nr. I brendshëm	633 / 018/ 007 / 121

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë

"FURNIZIMI ME KONTENJER PËR MBETURINA NE TERITORIN E KOMUNËS SË ISTOGUT

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 30. DITË pas porosisë se Autoritetit Kontraktues. nga dita e nënshkrimit të kontratës dhe të lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jenë Komuna Istog – PARKU I KOMUNES – Ose vendi ku do ta caktojnë palët me marrëveshje.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetët DDP

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet total ne baze te kësajë kontrate është: **19.595,80 €**

Nëntembëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë euro - 80/100

42. Oferta financiare e furnitorit e datës: **14.03.2018** është pjesë përbërëse e kësajë kontrate dhe bazë për pagesën e furnitorit.

4.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Kjo marrëveshje e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare;

Plani për menaxhimin e kontratës

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.



Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

<i>Për Autoritetin Kontraktues:</i>		<i>Për Kontraktorin:</i>	
Emri:	Zizë Bujupaj	Emri: Për	Shpejtim Kuçi
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.04.2018	Data:	24.04.2018
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA: BLERJA E KONTEJNEREVE PER MBETURINA

		Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma(€)
I	Furnizimi me kontejnere per mbeturina (per dimensione dhe llojin e kontejnerve- referohu Specifikimeve teknike te detyrueshme)	cope	70	279.94 €	19,595.80 €
	TOTALI ME TVSH:				19,595.80 €